



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2670/13 Prot.

Tiranë, më 17-10 2023

V E N D I M

Nr. 72 datë 17-10 2023

“PËR
NDARJEN E ORËVE TË PROJEKTIT SHAPE NË KUADËR TË THIRRJES ERASMUS
+”CAPACITY IN HIGHER EDUCATION”

Bazuar në nenin 49 të Ligjit nr.80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Udhëzimin nr.29 datë 10.09.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", në vendimin e Rektorit nr.265 datë 22.12.2022 "Për ngritjen e grupit të punës për thirrjen ERASMUS+CBHE" si dhe vijim të informacionit me email si projekt fitues nga Universiteti i Biznesit dhe Teknologjisë- Republika e Kosovës, në shkresën me nr.2332 Prot. datë 25.09.2023 ,me vendim Rektorati nr. 87 datë 18.09.2023, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 17.10.2023,

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndarjen e **350 orëve** për grupin e punës të angazhuar në aplikimin e Projektit Shape (Sport, Health and People) në kuadër të thirrjes Erasmus +”CAPACITY IN HIGHER EDUCATION”
2. Pagesat të kryhen nga të ardhurat dytësore.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek Transparenca universitare.

KRYETARI BORDIT TË ADMINISTRIMIT

P/ ARTUR COBANI

Ariton Sallari

